



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2024

VENDIM

Nr. 16, datë 18.01.2024

PËR

CAKTIMIN ME SHORT TË RELATORIT TË PROCEDIMIT DISIPLINOR NR. 1/2021, TË FILLUAR NDAJ MAGJISTRATES ZNJ. {...}, ME FUNKSION GJYQTARE NË GJYKATËN E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 63 të Ligjit nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, në nenet 138 dhe vijues të Ligjit nr. 96/2016, “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në nenin 16 të Rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur, mbi propozimin e Komisionit Disiplinor, pas hedhjes së shortit

VENDOSI:

1. Caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor, z. Markelian Koça, në cilësinë e relatorit të procedimit disiplinor nr. 1/2021, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj magjistrates, znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
2. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistrates, znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR